



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:034584
Datë: 13.03.2024
Numri i dokumentit: 05447329

Ac.nr.6355/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Naime Ahmeti kryetare e kolegjit, Nora Bllaca - Dula dhe Hidajete Gashi - Alaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëseve F.Sh., dhe G.S., që të dyja nga fshati M..... - Komuna Shtime, të cilat me autorizim i përfaqëson F.N., avokat nga Shtimja, kundër të paditurës Komuna e Shtimes - Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e shujtave ditore, duke vendosur sipas ankesës të së paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, C.2023:034585, të datës 24.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Shtimes - Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, C.2023:034585, i datës 24.08.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar ka vendosur si vijon:

I.APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëseve F.Sh., dhe G.S., nga fshati M....., Komuna Shtime, e ushtruar kundër të paditurës Komuna Shtime - Drejtoria Komunale e Arsimit.

II.DETYROHET e paditura Komuna Shtime - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve, në emër të shujtave ditore të u kompensojë dhe atë:

1.Paditëses F.Sh., për periudhën prej 01.09.2021 deri më 15.07.2022 në emër të shpenzimeve për shujta ditore për 164 ditë pune të i'a kompensoj shumën prej 328.00€ (treqind e njëzetë e tetë euro);

2.Paditëses G.S., për periudhën prej 01.09.2021 deri më 15.07.2022 në emër të shpenzimeve për shujta ditore për 109 ditë pune të i'a kompensoj shumën prej 218.00€ (dyqind e tetëmbëdhjetë euro).

Me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë me datë 08.02.2023 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 125.00 euro të gjitha në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.”

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e të paditurës në tërësi si të bazuar, ta ndryshoj aktgjykimin e atakuar ashtu që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë si të pa bazuar.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditëseve, përmes së cilës ka propozuar që të refuzohet ankesa e të paditurës si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditëset F.Sh., dhe G.S., kanë ushtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Shtimes - Drejtoria Komunale e Arsimit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për ditët e pranisë në punë për periudhën nga data 01.09.2021 deri me datë 15.07.2022, t'ua paguaj nga 2 euro në ditë për ditë, me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës.

Nga ana tjetër e paditura, përmes përgjigjes në padi, e ka kontestuar në tërësi si të pa bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke propozuar që të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas pranimit të përgjigjes në padi nga e paditura, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, e në pajtim me nenin 398 të LPK-së, jashtë shqyrtimi gjyqësor, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësieve, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të së paditurës, se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) i LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadsisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se nuk ishte kontestues fakti se paditëset janë në marrëdhënie pune me të paditurën Komuna e Shtimes – Drejtoria Komunale e Arsimit, në vendin e punës mësimdhënëse e gjuhës dhe letërsisë shqipe, fakt i vërtetuar nga kontrata e punës me numër protokollit 05/264 të datës 05.04.2017 për paditësen G.S., dhe vendi i punës si mësuese klase për paditësen F.Sh., fakt i vërtetuar kontrata e punës me numër protokollit 05/314/148/01 të datës 03.09.2018, po ashtu nuk ishte kontestues se paditësja G.S., për 109 ishte në vendin e punës në periudhën kohore nga data 01.09.2021 e deri me datë 15.07.2022, fakt i vërtetuar nga vërtetimi me numër protokollit 12/2023 i datës 23.01.2023, si dhe paditësja F.Sh., për 164 ditë ishte në vendin e punës në periudhën kohore nga data 01.09.2021 deri me datë 15.07.2022, fakt i vërtetuar nga vërtetimi me numër protokollit 13/2023 i datës 23.01.2023, për të paditurën kontestuese ishte baza juridike e kërkesëpadsisë së paditëseve.

Me nenin 35 paragrafin 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021 përcaktohet se *“Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë së paditëseve, duke e obliguar të paditurën që në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për ditët e pranisë në punë, t’ua paguaj shumat si në dispozitiv të aktgjykimit ankimor, me të drejtë janë bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e parashtrimit të kërkesës për kompensimin e shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të ushqimit për ditët në punë, që rrjedhimisht nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadsisë.

Mes palëve nuk ishte kontestues fakti se paditëset ishin në marrëdhënie pune tek e paditura, kontestuese nuk ishte as prania e paditëseve në punë, kontestuese nuk ishte po ashtu as rrethana se e paditura Komuna e Shtimes nuk ka bërë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në punë, por kontestuese ishte parashkrimi i kërkesës së paditëseve, gjë që vërtetohet edhe nga përgjigja në padi e të paditurës.

Gjykata e Apelit, mori parasysh pretendimin ankimor të të paditurës lidhur me faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nuk janë përmbushur kushtet e parapara me nenin 46 të kësaj Kontrate, meqënëse nënshkruarit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare. Lidhur me këto pretendime, Gjykata e

Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, i takojnë pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësit, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Pretendimi ankimor i të paditurës se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, është shkëputur njëanshëm nga Ministria e Arsimit me datë 21.11.2023 dhe paditëseve nuk iu takon kompensimi i shujtave pasi që Kontrata nuk është më në fuqi, është i paqëndrueshëm, për faktin se paditëset padinë e kanë parashtruar në gjykatë me datë 02.02.2023, ndërsa kompensimin e shujtave e kërkojnë brenda periudhës datë 01.09.2021 deri me datë 15.07.2022, sa ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, andaj kërkesëpadisë së paditëseve nuk i mungon baza ligjore.

Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452.1 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.6355/2023, me datë 13.03.2024

Kryetare e Kolegjit
Naime Ahmeti, d.v.